



Pranuar / Dorezuar Punimjen/Prodato Received/Delivery	09.02	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SJK	552/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1144/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1144/2021 të datës 15.12.2021 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë [redacted] kundër Vendimit me Nr. Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 04.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura lidhur me ankesën A.nr.1144/2021 të datës 15.12.2021 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tutje referuar si AKP), me datën 15.12.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 6129/2021 të regjistruar me numër A.nr.1144/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, me pretendimin ankimor se ulja e pagës në masën prej 23% sipas këtij vendimi është në kundërshtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë, Ligjin e Pagave të Nëpunësve Civilë dhe vetë kontratën e punës.

Departamenti i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes emailit zyrtar të datës 03.02.2022, ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil

të Kosovës, lidhur me Aktgjykimin C-IV-21-0231 të datës 01.02.2022 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përmes të cilit aktgjykim gjykata ka hedhur poshtë si të pa themeltë padinë/kërkesë padinë e përbashkët të ankuesve me të cilën kanë kërkuar anulimin e Vendimit të Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit Nr.Ref.BD-153/9 të datës 29.10.2021 lidhur me zbatimin e Rregullores Nr.02/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Pagave të nëpunësve të Agjencisë, si dhe Propozimin për masën e sigurisë me të cilin do t'i ndalohej të paditurës që të mos bëjë ulje të pagave deri në vendosjen e çështjes me vendim përfundimtar nga gjykata.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke marrë parasysh se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin C-IV-21-0231 të datës 01.02.2022 ka konstatuar se kërkesa/padia me kërkesë padi është e pranueshme për procedim në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, por e pathemeltë, dhe meqenëse Aktgjykimi C-IV-21-0231 i datës 01.02.2022 nuk është përfundimtar sepse kundër të njëjtit lejohet e drejta e ankesës brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit, Kolegji në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit"*, si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për **pezullim të procedurës në lidhje me ankesën A.nr.1144/2021.**

Procedura lidhur me ankesën A.nr.1144/2021 e datës 15.12.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, do të mbetet e pezulluar deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështjes në gjykatën kompetente.


Duke u bazuar si me lartë, dhe në mbështetje të nenit nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1144/2021

Ardita Perguku-Shyti


Procesmbajtëse

Malsore Gasiri-Bajraktari


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses [REDACTED]
- Drejtorit Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP);
- Udhëheqësit të Njësisë për Burime Njerëzore në AKP dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

